



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 25 datë 20.4.2021

**“PËR DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIEN ME QIRA NË FAVOR TË SUBJEKTIT
‘RESTORANT PIZZERIA ITALIA’ TË NJË SIPËRFAQE PREJ 27 M²,
NR.PASURIE 4/254, ZK 8594 ,VOL 9, FAQE 83, NË PRONËSI TË BASHKISË
SHKODËR ”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 20.4.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1/1.2, germa “a” dhe “c”, nenin 36, nenin 54 germa “e/1” të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar; ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar; VKM nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; VKM nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut Shkodër” të ndryshuar; VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për percaktimin e kriterëve, te procedures e te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore” të ndryshuar; Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar; si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e pëlqimit për dhënien me qira në favor të subjektit ‘Restorant Pizzeria Italia’ të një sipërfaqe prej 27 m², nr.pasurie 4/254, zk 8594, vol 9, faqe 83 në pronësi të Bashkisë Shkodër .
2. Kontrata e qirasë parashikohet të lidhet për një afat 1 vjecar .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

K R Y E T A R


Brisela **KADIJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 21.4.2021

Pt.6958 05.05.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 352/1 prot.

Shkodër, më 04.05.2021

LËNDA: Kërkesë për saktësim dhe informacion mbi VKB Shkodër nr.25 datë 20.04.2021 "Për dhënie pëlqimi me qira në favor të subjektit.....".

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR
Brisela KADIJA
Kryetare

BASHKISË SHKODËR
Znj. Voltana ADEMI
Kryetare

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", Aktit Normativ Nr.3 date.15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", neni 56 KPAD, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 54/e/1, neni 55/3, ligjit Nr.8743 date.22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme te shtetit" i ndryshuar, ligjit Nr.8744 datë.22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, shkresës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër Nr.3417/1prot datë 10.03.2021 "Informacion", shqyrtoi VKB Shkodër nr.25 datë 20.04.2021 "Për dhënie pëlqimi me qira në favor të subjektit "Restorant Pizzeria Italia", të një sipërfaqe prej 27 m², në pronësi të Bashkisë Shkodër".

Pas shqyrtimit konstatohet si vijon:

Sipas dokumentacionit i paraqitur nga organi propozues Bashkiak Shkodër, pranë këshillit bashkiak) vërehet se VKM Nr.421 date.2.06.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër, Qarkut Shkodër", i ndryshuar, shprehet se prona me nr.rendor 220 me nr.pasurie 4/254 i është transferuar bashkisë Shkodër me fushë përdorimi, realizim program kulturore, (citohet kjo në mungesë të certifikatës së pronësisë).

Referuar VKM Nr.54 date 5.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, dhënia me qera e sipërfaqeve deri në 200 m² të cilat jepen me afat deri në 1 vit, përjashtohen nga konkurrimi publik. Kjo do të thotë që Këshilli Bashkiak ka tagrin të japë dakortësinë për dhënie me qera të objektit, pasuri shtetërore, madje pa u shprehur se kush është përfituesi,

Ju sillet në vëmendje se praktika gjyqësore e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për çështjet e pronës, sqaron se mosregjistrimi i pronës në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk shkakton pavlefshmëri, por nuk ju jep mundësi të shfrytëzoni elementin e tjetërsimit tek të tretët,

Për sa trajtuar, këshilli bashkiak sipas rregullores së tij miratuar me VKB nr.60 datë 28.12.2020 (komisioni specifik) së bashku me administratën e bashkisë Shkodër, të saktësojnë fushën e përdorimit sipas VKM Nr.421 date.2.06.2010.

Prefekti, mbetet në pritje të sqarimit mes organit propozues Bashkia Shkodër dhe organit vendimarrës Këshilli Bashkiak Shkodër.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

